

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6876
E enjte, 20 prill 2023
Çmimi 0.40

ShBA-ja pret zbatimin
e marrëveshjeve të
mëparshme në mes të
Kosovës dhe Serbisë I FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

MBAHET CEREMONIA E NËNSHKRIMIT TË LIBERALIZIMIT
TË VIZAVE PËR KOSOVËN I FAQE 4-5

NËNSHKRUHET LIBERALIZIMI I VIZAVE PËR KOSOVËN



Në selinë e Parlamentit Evropian në Strasburg të mërkurën është nënshkruar akti ligjor i Bashkimit Evropian (BE) për liberalizimin e vizave për Kosovën. Pas nënshkrimit të këtij vendimi, hapi i fundit mbetet botimi i

vendimit në Gazetën Zyrtare. Raportuesi për Kosovën, Thijs Reuten, ka bërë me dije se më së largu nga 1 janari i vitit 2024 shtetasit e Kosovës do të mund të udhëtojnë pa viza në Zonën Schengen. Ndërsa

zëvendëskryeministri Besnik Bislimi, pasi i ka falënderuar qytetarët e Kosovës për durimin, ka thënë se do të nisin fushatë vetëdijesuese lidhur me kufizimet që vijnë me liberalizimin e vizave

AKTUALE



BIK-u: TË ENJTEN PËRFUNDON
RAMAZANI, TË PREMTEN FESTA E
FITËR BAJRAMIT F. 3

HAXHIU: KODI CIVIL DUHET TË
VOTOHET, PO KOORDINOHEMI ME
DEPUTETËT E LV-së F. 5

SPITALI I PEJËS: PËR NJË VIT U
OPERUAN 1 225 PACIENTË F. 6

EKONOMI



ÇMIMET E BILETAVE NË TRANSPORTIN
NDËRURBAN MUND TË RRIJEN PËR 25
PËR QIND F. 8

GËRXHALIU: KONTRIBUTI DHE
POTENCIALI I DIASPORËS ËSHTË
SHUMË MË I MADH SESA
QË PRANOHET NË KOSOVË F. 8

ZGJEDHJET
NË VERI: KU
DHE SI DO TË
VOTOHET?



ÇITAKU: KUVENDI NUK ËSHTË
PËR SHOU, ËSHTË VEND PUNE,
LV-ja PO DËSHTON TA SIGUROJË
SHUMICËN E NEVOJSHME



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mbx: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË



PRISHTINA DHE GJILANI KUALIFIKOHEN
NË FINALE TË KUPËS F. 10

SPORT

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

India, nga qershori, vendi më i populluar në botë

NEW DELHI, 19 PRILL - India pritet ta kalojë Kinën si vendi më i populluar në botë deri në mesin e këtij viti, me pothuajse tre milionë banorë më shumë, sipas parashikimeve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Popullsia e Indisë do të numërojë 1 4286 miliard banorë në mesin e vitit 2023, krahasuar me atë të Kinës prej 1 4257 miliard banorësh, ka treguar një raport i Fondit të OKB-së për Popullsinë, i publikuar më 19 prill.

Numri i banorëve në Kinë është tkurrur për herë të parë që nga viti 1960, kur miliona njerëz vdiqën nga uria për shkak të

politikave katastrofike bujqësore të ish-udhëheqësit Mao Zedong. Shumë njerëz kanë vlerësuar se përgjegjës për ngadalësim janë rritja e kostos së jetesës si dhe rritja e numrit të grave të punësuar dhe me arsimim të lartë, raporton AFP.

Pekini ka ndërprerë më 2016 politikën e rreptë "një fëmijë", të vendosur në vitet 1980, mes frikës nga mbipopullimi, dhe nga viti 2021 ka filluar t'u lejojë çifteve të kenë tre fëmijë.

India nuk ka të dhëna të reja zyrtare se sa banorë i ka, sepse nuk ka kryer regjistrim të popullsisë që nga viti 2011.

Regjistrimi, që India e bën një herë në dekadë, ishte paraparë të kryhej më 2021, por është shtyrë për shkak të pandemisë së koronavirusit.

Kritikët thonë se qeveria po e shtyn qëllimisht regjistrimin, për t'i fshehur të dhënat për çështje të nxehta, si papunësia, para zgjedhjeve kombëtare, që parashihen të mbahen vitin e ardhshëm.

Sipas qendrës hulumtuese Pew, popullsia e Indisë është rritur më shumë se një miliard banorë që nga viti 1950, kur OKB-ja filloi të mbledhte të dhëna për popullsinë.



Interpol: Mbi 200 tonë drogë janë konfiskuar në Amerikën Latine



LION, 19 PRILL - Autoritetet në Amerikën Latine kanë arrestuar 14 260 njerëz dhe kanë konfiskuar rreth 200 tonë kokainë në kuadër të një operacioni të madh, të udhëhequr nga Organizata Ndërkombëtare e Policisë (Interpol).

Në periudhën 12 mars - 2 prill autoritetet kanë konfiskuar 203 tonë të kokainës dhe droga të tjera, vlera e të cilave arrin në rreth 5.7 miliardë dollarë.

Përgjatë operacionit janë konfiskuar edhe mbi 8 200 armë të paligjshme dhe 305 000 fishekë.

Operacioni është thënë të jetë zhvilluar në 15 shtete.

Në total, autoritetet kanë ndërprerë veprimtarinë e 20

grupeve kriminale, përfshirë sindikatën braziliane të kimit, Primeiro Comando da Capital, bandën e të rinjve të Salvadorit, Mara Salvatrucha dhe Kartelin e Ballkanit, që është aktiv edhe në Amerikën Jugore. "Fakti që një operacion i konfiskimit të armëve ka rezultuar në kapje të një sasive kaq të madhe të drogës, dëshmon se këto krime janë të ndërlydhura", ka thënë sekretari i përgjithshëm i Interpolit, Jurgen Stock, duke shtuar se rrjetet e kimit të organizimit, me të gjitha aktivitetet e paligjshme, e kanë vetëm një prioritet, profitin. "Ne, si zyrtarë për zbatim të ligjit, duhet të tregojmë vendosmëri për t'i shkatërruar këto grupe në çdo rajon të botës", ka thënë Stock.

Hungaria zgjeron ndalesën ndaj importeve të produkteve ukrainase

BUDAPEST, 19 PRILL - Qeveria e Hungarisë ka zgjerrur ndalesën e përkohshme ndaj importeve të produkteve bujqësore ukrainase dhe ka përfshirë mjaltin, verën, bukën, sheqerin dhe një sërë produktesh të mishit dhe perime.

Lista e produkteve të ndaluara u publikua përmes një dekreti qeveritar, pasi Budapesti njoftoi të shtunën se ka ndërmarrë masë për ta ndaluar importin e drithërave, farërave vajore dhe disa produkteve të tjera.

Në ditët e fundit Polonia, Hungaria dhe Sllovakia kanë ndaluar importin e drithërave dhe produkteve të tjera nga Ukraina - shtet që po përballet me pushtimin rus - pasi çmimet e lira për produktet

ukrainase nxitën pakënaqësi në mesin e fermerëve lokalë.

Bullgaria pritet të njoftoi për masë të ngjashme gjatë 19 prillit.

Në maj të vitit 2022 Bashkimi Evropian lejoi Kievin që të eksportonte drithëra përmes shteteve të bllokut pas mbylljes së linjave transportuese në Detin e Zi për shkak të luftës së Rosisë. Bllokadat në portet e Detit të Zi nxitën krizë globale ushqimore.

Shtetet anëtare janë pajtuar të importojnë produkte të caktuara nga Ukraina pa kufizime të sasisë dhe pa inspektim të doganës. Megjithatë, një pjesë e madhe e produkteve nuk kanë kaluar transit përmes BE-së, por janë shitur në tregjet e shteteve

anëtare me çmim të lirë, tha Budapesti. "Në mungesë të obligimit për t'iu përmbajtur rregullave strike të produkteve, siç kërkohet sipas ligjeve të BE-së, produktet ukrainase kanë avantazh në konkurrencë ... gjë që shkakton telashe të mëdha në tregjet e brendshme të shteteve anëtare", u tha në dekretin e qeverisë hungareze. Në dekretin e Qeverisë në Budapest u tha se ndalesa do të aplikohet edhe për miellin, vajin e gatimit si dhe për verërat. Kjo ndalesë e përkohshme do të jetë në fuqi deri më 30 qershor, por nuk do të aplikohet për produktet që kalojnë transit përmes Hungarisë, u tha në dekret. Autoritetet hungareze do t'i izolojnë në doganë dërgesat e



produkteve që janë në listën e ndalesës dhe do t'i monitorojë ato përmes pajisjeve elektronike.

Transportuesit që shkulin ndalesën do të gjobiten bazuar në vlerën totale të dërgesës që

transportojnë.

Polonia dhe Ukraina të martën arritën një marrëveshje që mundësoi transitin e drithërave ukrainase përmes Polonisë, pasi Varshava kishte vendosur ndalesë ndaj importeve.

MBAHET CEREMONIA E NËNSHKRIMIT TË LIBERALIZIMIT TË VIZAVE PËR KOSOVËN

Nënshkruhet liberalizimi i vizave për Kosovën

Në selinë e Parlamentit Evropian në Strasburg të mërkurën është nënshkruar akti ligjor i Bashkimit Evropian (BE) për liberalizimin e vizave për Kosovën. Pas nënshkrimit të këtij vendimi, hapi i fundit mbetet botimi i vendimit në Gazetën Zyrtare. Raportuesi për Kosovën, Thijs Reuten, ka bërë me dije se më së largu nga 1 janari i vitit 2024 shtetasit e Kosovës do të mund të udhëtojnë pa viza në Zonën Schengen. Ndërsa zëvendëskryeministri Besnik Bislimi, pasi i ka falënderuar qytetarët e Kosovës për durimin, ka thënë se do të nisin fushatë vetëdijesuese lidhur me kufizimet që vijnë me liberalizimin e vizave

EPOKA
ERE

Lirim GECI

STRASBURG, 19 JANAR - Në Strasburg është nënshkruar akti ligjor i Bashkimit Evropian për liberalizimin e vizave për Kosovën. Në ceremoninë e nënshkrimit të këtij akti, e cila është drejtuar nga shefja e Parlamentit Evropian (BE), Roberta Metsola, kanë marrë pjesë një përfaqësues i Suedisë, e cila kryeson Bashkimin Evropian në këtë periudhë, raportuesi për Kosovën, Thijs Reuten, dhe zëvendëskryeministri i parë i Kosovës, Besnik Bislimi, e ministria e Punëve të Jashtme, Donika Gërvalla-Schwarz. Pas nënshkrimit të këtij vendimi, hapi i fundit mbetet botimi i vendimit në Gazetën Zyrtare.

Raportuesi i Parlamentit Evropian për liberalizimin e vizave për Kosovën, Thijs Reuten, në një konferencë për medie, mbajtur pas nënshkrimit të vendimit, ka bërë me dije se më së largu nga 1 janari i vitit 2024 shtetasit e Kosovës do të mund të udhëtojnë pa viza në Zonën Schengen. Ai ka thënë ka thënë se ishte e padrejtë dhe e paarsyeshme zvarritja e procesit të vizave për Kosovën pavarësisht se Prishtina zyrtare kishte "punuar shumë dhe kishte plotësuar (kriteret) para

shumë vjetësh". "Ky vendim nuk është kuptimplotë vetëm për Kosovën, për shkak se të gjithë shtetasit e tjerë të rajonit kanë mundur të udhëtojnë, përveç Kosovës. Ishte i padrejtë, i paarsyeshëm dhe kësaj shtetashmë i ka ardhur fundi. Kosova ka punuar shumë për t'i plotësuar të gjitha kushtet dhe për t'i përmbushur ato para shumë vjetësh dhe tashmë po shpërblehet për këtë gjë. Por, nuk është vetëm moment i rëndësishëm së madhe për Kosovën, por është me rëndësi edhe për ne, pasi BE-ja përfundimisht e përmbushi premtimin e vet", ka thënë Reuten, duke shtuar se ishte i befasuar me kushtin që i ishte vënë Kosovës me sistemin ETIAS.

Reuten ka thënë se ETIAS-i nuk duket të jetë funksional deri më 1 janar 2024, duke shtuar se kushti nëse ETIAS-i është funksional apo jo më herët nuk do të përdoret. "Dhe, për këtë ka qenë e rëndësishme që të kishim një datë të fundit në marrëveshje dhe duke i parë zhvillimet përreth implementimit të ETIAS-it, me gjasë do ta presim atë datë", ka thënë Reuten.

Ndërsa zëvendëskryeministri Bislimi ka thënë se nga janari i vitit 2024 nuk do të ketë "mijëra mundësi të humbura" për shtetasit e Kosovës. Ai ka thënë



se ky vendim ka të bëjë pikë së pari me qytetarët, por ka të bëjë edhe "me Kosovën më afër BE-së, por edhe për BE-në më afër Kosovës". "Është mesazh për qytetarët se edhe ne jemi pjesë e Evropës. Ka të bëjë me studentët, sportistët, të cilët mund ta eksplorojnë Evropën", ka thënë ai.

Më tutje, Bislimi ka thënë se autoritetet në Kosovë do të nisin fushatë vetëdijesuese lidhur me kufizimet që vijnë me liberalizimin e vizave. "Dua t'i falënderoj të gjithë qytetarët për durimin. Do të bëjmë fushata për t'i njoftuar ata se çfarë është dhe çfarë nuk është

liberalizimi", është shprehur Bislimi.

Kujtojmë se të martën Parlamenti Evropian e ka miratuar vendimin për vizat, duke përmbyllur procedurat vendimmarrëse për këtë çështje. Miratimi është bërë pa votim, pasi nuk kishte asnjë kundërshtim dhe ua ka hapur rrugën qytetarëve të Kosovës që të lëvizin pa viza në vendet e Zonës Schengen prej 1 janarit të vitit 2024.

Regjimi pa viza mundëson udhëtime vetëm deri në 90 ditë brenda gjashtë muajsh - në cilindo nga shtetet anëtare të Zonës Schengen.

Udhëtimet pa viza duhet të shërbejnë për vizita turistike, çështje familjare ose të ngjashme, dhe në asnjë rast nuk nënkuptojnë leje pune ose përfitime të tjera.

Kosova, aktualisht, është vendi i vetëm në Ballkanin Perëndimor, qytetarët e të cilit nuk mund të lëvizin lirshëm në zonën Schengen. Kjo, me gjithë faktin se Komisioni Evropian, qysh në vitin 2018, ka konfirmuar disa herë se Kosova i ka përmbushur të gjitha kushtet për liberalizimin e vizave, por kanë qenë disa vende anëtare që vazhdimisht kanë shprehur rezerva.

BIK-u: Të enjten përfundon Ramazani, të premtën festa e Fitër Bajramit

PRISHTINË, 19 PRILL - Bashkësia Islame e Kosovës ka njoftuar se muaji i madhëruar Ramazan përfundon të enjten, më 20 prill 2023, ndërkaq dita e parë e festës së Fitër Bajramit është të premtën, më 21 prill.

Në njoftimin e BIK-ut bëhet me dije se manifestimi qendror për festën e Fitër Bajramit për Republikën e Kosovës mbahet në Xhaminë e Madhe në Prishtinë. Manifestimi fillon në orën

5.05, me faljen e namazit të sabahut, pas të cilit do të jetë ligjërata tematike kushtuar kësaj feste nga teologu Muhamed Stublla.

Namazi i Fitër Bajramit falet në orën 06:23, të cilit do t'i prijë kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat Sahiti.

Hytben e Fitër Bajramit do ta mbajë myftiu i Kosovës, Naim Tërnavë, i cili do t'i drejtohet opinionit të gjerë me mesazhin e kësaj feste.

Me rastin e festës së Fitër Bajramit, ditën e parë, më 21 prill 2023, Kryesia e BIK-ut, si tradicionalisht, organizon pritje përurimi në selinë e Kryesisë nga ora 9:00-12:00. "Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës ua uron festën e Fitër Bajramit të gjithë besimtarëve dhe opinionit të gjerë, duke e lutur Zotin t'i ketë pranuar agjërimin, lutjet dhe ibadetet tona. Me fat festa e Fitër Bajramit!", thuhet në njoftimin e BIK-ut.





Zgjedhjet në veri: Ku dhe si do të votohet?

Në katër komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës, ku më 23 prill do të mbahen zgjedhjet e parakohshme lokale, do të hapen gjithsejtë 19 qendra të votimit, prej të cilave 13 do të jenë alternative apo të ashtuquajtura "kontejnerë". Në të kaluarën në këtë zonë janë hapur 44 qendra votimi

PRISHTINË, 19 PRILL - Më 23 prill qytetarët me të drejtë vote në katër komunat në veri të Kosovës, të banuara me shumicë serbe, do t'u drejtohen qendrave të votimit për të zgjedhur katër kryetarë të rinj dhe dy përbërje të reja të asambleve komunale. Por, për dallim nga herët e kaluara, në këto zgjedhje - që bojkotohen nga partia më e madhe e serbëve në Kosovë, Lista Serbe - votimet, përveçse në disa shkolla, do të mbahen edhe në kontejnerë.

Pse po mbahen zgjedhjet?

Më 5 nëntor të vitit 2022 kryetarët e Mitrovicës së Veriut, Leposaviqit, Zveçanit e Zubin Potokut nga Lista Serbe kanë dhënë dorëheqje. Ata, së bashku me asamblistët komunalë dhe zyrtarë të tjerë nga sektori i sigurisë e drejtësisë, e morën këtë vendim në shenjë pakënaqësie me një vendim të Qeverisë së

Kosovës, që i obligonte serbët t'i zëvendësonin targat e makinave të tyre, të lëshuara nga Serbia, me ato RKS - Republika e Kosovës.

Dorëheqjet kolektive krijuan vakum institucional dhe bënë që mbajtja e zgjedhjeve të jashtëzakonshme të caktohej fillimisht për datën 18 dhjetor të po atij viti.

Procesi në këtë datë u anulua, pas rritjes së tensioneve në veri. Grupe të serbëve lokalë sulmuan më 6 dhjetor zyrtarët zgjedhorë në Mitrovicë të Veriut dhe Zubin Potok, të cilët po përgatitnin mbajtjen e zgjedhjeve.

Tensionet vazhduan dhe kulmuan me disa incidente me armë zjarri dhe me vendosjen e barrikadave në rrugët që çonin drejt dy vendkalimeve kufitare me Serbinë: Jarinjë dhe Bërnjak.

Barrikadat u vendosën pas arrestimit të ish-policit serb të Kosovës, Dejan Pantiq, i akuzuar për sulm kundër zyrtarëve zgjedhorë. Ato u hoqën pas disa javësh,

përkatësisht pasi Pantiqit i ndryshua masa e paraburgimit me atë të arrestit shtëpiak.

Kosova dhe Serbia, ndërkohë, arritën marrëveshje për çështjen e targave. Kosova hoqi dorë nga ndëshkimet që parashihte vendimi për shoferët që kanë makina me targa ilegale serbe, ndërsa Serbia u pajtua të mos lëshonte më targa me emërtime për qytetet e Kosovës, sikurse KM (Mitrovica e Kosovës), PR (Prishtinë) e të ngjashme.

Kush do të garojë në zgjedhjet e 23 prillit?

Për zgjedhjet për katër kryetarët në veri do të garojnë 11 kandidatë, dy prej të cilëve vijnë nga komuniteti serb. Subjektet në garë janë: Iniciativa Qytetare Mitrovica, Partia Demokratike e Kosovës, Partia e Serbëve të Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje, si dhe një kandidat e pavarur. Në zgjedhjet lokale të 23 prillit partia kryesore serbe, Lista Serbe, nuk merr pjesë.

Zgjedhje do të mbahen edhe për të zgjedhur dy asamble të reja komunale: në Leposaviq dhe në Zveçan.

Numri i përgjithshëm i qytetarëve që mund të votojnë, sipas Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, është 45 095.

Më 23 mars, një ditë pas

përfundimit të afatit për paraqitjen e kandidaturave në KQZ, Lista Serbe tha se nuk do të marrë pjesë në zgjedhje për shkak të "pasojave të dhunës së vazhdueshme institucionale" të cilat "i zbaton regjimi i [kryeministrit të Kosovës] Albin Kurti". "Para së gjithash, për shkak të mospërbushjes së kërkesave tona të qarta, të cilat ishin arsye pse u larguam nga institucionet e Kosovës, përkatësisht: formimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe dhe tërheqja e të gjitha forcave speciale nga veriu i Kosovës", u tha në njoftimin e Listës Serbe.

Ajo nuk solli ndonjë provë që do t'i mbështeste pretendimet e saj për "dhunë institucionale".

Votimi në kontejnerë

Votimet për zgjedhjet në Kosovë zakonisht zhvillohen në shkolla. Në veri, sipas KQZ-së, në të kaluarën janë hapur 44 qendra të votimit. Por, për zgjedhjet e 23 prillit, të hapura do të jenë 19 qendra votimi, 13 prej të cilave do të jenë të vendosura në kontejnerë.

Hapja e qendrave të votimit në shumë shkolla, kësaj radhe, u bë e pamundur, pasi ato kontrollohen nga strukturat që punojnë sipas sistemit të Serbisë, i cili i kundërshton zgjedhjet.

Prandaj, KQZ-ja tha se qendrat

alternative do të jenë në kontejnerë, që do të vendosen në lokacione të ndryshme në katër komunat në veri.

Çfarë u tha në Prishtinë dhe në Beograd për zgjedhjet?

Vendimi për mbajtjen e zgjedhjeve në veri u përcoll me qëndrime të ndryshme në Prishtinë dhe në Beograd. Përdorisa autoritetet në Kosovë e akuzuan Serbinë se përmes medieve po i "frikëson" serbët e veriut që të marrin pjesë në zgjedhje, ato në Serbi thanë se vendimin për mospjesëmarrje në zgjedhje Lista Serbe e ka marrë vetë.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, deklaroi më 18 prill se nuk ka informacione se po përgatiten pengesa për procesin zgjedhor. Megjithatë, ai tha se Beogradi po kërkon nga serbët që të mos marrin pjesë në të. "Unë i ftoj të gjithë këta që kanë të drejtë vote, të dalin dhe të votojnë. E di që kjo qëndron në kontrast me thirrjet që vijnë nga kryeqyteti i fqinjit tonë verior. Por, ne nuk kemi informacione, të cilat do të na bëjnë të mendojmë që po përgatiten pengesa, pengime të këtij procesi, përveç frikësimit mediatic që vjen nga Beogradi zyrtar", tha Kurti.

Kurti u shpreh i bindur se

Çitaku: Kuvendi nuk është për shou, është vend pune, LV-ja po dështon ta sigurojë shumicën e nevojshme

PRISHTINË, 19 PRILL - Nënkyetarja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Vlora Çitaku, ka reaguar pas mungesës së vazhdueshme të kuorumit në Kuvendin e Kosovës. Çitaku e ka fajësuar partinë në pushtet që po dështon ta sigurojë shumicën e nevojshme në Kuvend, duke thënë se kjo është papërgjegjësi. “Një parti që ka fituar mbi 50 për qind të votave dështon në

mënyrë të vazhdueshme të sigurojë shumicën e nevojshme në Kuvend. Papërgjegjësi e skajshme”, ka shkruar Çitaku. Ajo ka shtuar se Kuvendi nuk është për shou, por është vend pune. “Puna e parë dhe kryesore e deputetëve është miratimi dhe inicimi i nismave ligjore. Jo hajt pak. Jo deklarimet jashtë rendit të ditës. Jo shou. Është vend pune. Është kontratë me qytetarin”, ka shkruar Çitaku në

“Facebook”.

Lidhur me këtë, kryeparlamentari Glauk Konjufca ka thënë se legjislatura aktuale nuk e meriton të vazhdojë për shkak të sjelljeve të papërgjegjshme të deputetëve. “Qysh po e shoh këtë sjellje të papërgjegjshme të disa deputetëve, nuk po mendoj se kjo legjislaturë e meriton të vazhdojë”, ka deklaruar Konjufca.



Haxhiu: Kodi Civil duhet të votohet, po koordinohemi me deputetët e LV-së

PRISHTINË, 19 PRILL - Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka thënë se janë në koordinim me deputetët e grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, që Kodi Civil të votohet. Ndonëse është rrëzuar herën e parë, Haxhiu ka thënë se nuk është mirë për Kosovën që mos ta votojë një dokument që ka të bëjë me të drejtat e njeriut. “Ju e dini se unë kam dhënë qëndrim sa i përket Kodit Civil dhe unë kam dhënë qëndrim sa i përket rrëzimit nga ana e Kuvendit, megjithatë ka qenë nën mandatin e tyre ta vlerësojnë ashtu. Paraprakisht ne duhet të sigurohemi që Kodi

Civil kalon dhe për këtë arsye kjo na ka marrë kohë, sepse jemi në koordinim me deputetët e grupit parlamentar dhe natyrisht se kemi nevojë edhe për ndihmën e opozitës” ka deklaruar Haxhiu, duke shtuar se tendenca është që i njëjti të kalojë dhe mos ta ketë fatin siç e ka pasur në të kaluarën. “Nuk mendoj se është mirë për Kosovën që ne pretendojmë të anëtarësohemi në Këshillin e Evropës që mos ta votojmë në dokument që ka të bëjë me të drejtat e njeriut, prandaj uroj që të kalojë në Kuvendin e Kosovës”, ka thënë Haxhiu.

zgjedhjet do të mbahen dhe tha se në disa komuna mund të ketë edhe raund të dytë.

Në anën tjetër, presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, tha se pas 24 prillit Kurti “do të jetë kryetar i Mitrovicës së Veriut”, duke aluduar se serbët nuk do të marrin pjesë në proces zgjedhor.

Ai, po ashtu, përsëriti kushtet e serbëve që të kthehen në institucionet e Kosovës: formimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe dhe tërheqja e njëjësve speciale të Policisë së Kosovës nga veriu i Kosovës.

Në Prishtinë, megjithatë, kishte edhe zëra kundër mbajtjes së zgjedhjeve.

Organizata joqeveritare Demokracia në Veprim (DnV) deklaroi në fillim të prillit se rrethanat aktuale “nuk mundësojnë organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve në veri” sipas standardeve për zgjedhje të lira. Kjo organizatë tha se fakti që nuk ka shumë kandidatë nga radhët e komunitetit serb - pasi në katër komunat në veri mbi 90 për qind e popullsisë është serbe - mund ta cenojë legjitimitetin e institucioneve që do të dalin

nga këto zgjedhje, pasi “nuk garantohet përfaqësim i drejtë i komunitetit serb”.

DnV e konsideroi “të brishtë” situatën në veri.


Por, për ministrin e Punëve të Brendshme të Kosovës, Xhelal Sveçla, gjendja në veri, që nga përfundimi i luftës më 1999, nuk ka qenë e mirë. Gjatë një raportimi para një komisioni parlamentar më 14 prill, ai tha se “çështja e sigurisë në veri kurrë nuk ka qenë më e mirë, institucionet e sigurisë kurrë nuk kanë bërë punë më të mirë”.

Kundër mbajtjes së zgjedhjeve u shpreh edhe ish-kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, aktualisht deputet i partisë opozitare, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

Gjatë një fjalimi në Kuvendin e Kosovës, Haradinaj tha se për shkak të gjendjes në veri, autoritetet do të duhej ta shtynin mbajtjen e zgjedhjeve.

Çfarë thanë ndërkombëtarët?

Shtetet e Bashkuara, Britania e Madhe, Gjermania, Franca dhe Italia - që njihen si shtetet e



Quint-it - bënë thirrje që më 23 prill “të gjitha palët të ushtrojnë përmajtje dhe ta shmangin dhunën” që do të mund ta prishte procesin zgjedhor.

Shtetet e Quint-it shprehën keqardhje që në zgjedhjet e jashtëzakonshme në veri Lista

Serbe nuk e shfrytëzoi “të drejtën demokratike për të marrë pjesë në to”.

Keqardhje, ngjashëm, shprehu edhe Bashkimi Evropian.

“Zgjedhjet janë gur themeli i demokracisë dhe BE-ja gjithmonë e ka theksuar

rëndësinë e gjithëpërfshirjes”, tha zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, për “Radion Evropa e Lirë” më 27 mars.

Sipas tij, më e rëndësishme është që këto zgjedhje të mbahen në kushte paqësore. /Rel/

Spitali i Pejës: Për një vit u operuan 1 225 pacientë

PEJË, 19 PRILL - Katër kirurgë të përgjithshëm dhe dy kirurgë të fëmijëve që punojnë në kuadër të Spitalit të Përgjithshëm të Pejës, me shumë sukses, gjatë vitit 2022, kanë operuar gjithsej 1 225 pacientë, me patologji të ndryshme nga fusha e kirurgjisë. Në këtë spital, me

asistim dhe bashkëpunim me ekspertë të njohur nga Italia, me të cilët ka bashkëpunim të rregullt nga paslufta, janë kryer edhe operacione të tjera të rralla dhe të komplikuar. Në këtë spital ndërhyrjet kirurgjike kryhen edhe për pacientët nga komunat e

tjera nga rajoni i Dukagjinit. Krahas operacioneve të kryera, janë bërë edhe 1 593 vizita ambulatore nga mjekët e këtij reparti. Në dy muajt e parë të këtij viti mjekët kryen 201 operacione kirurgjike, në muajin janar 103 operacione dhe në muajin shkurt 98 operacione.



Mbahet programi përmbyllës i fushatës "Art për shpresë"

PRISHTINË, 19 PRILL - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka marrë pjesë të martën në mbrëmje në programin përmbyllës të fushatës "Art për shpresë".

Osmani ka thënë se është nderuar që të jetë në këtë iftar të përbashkët, ku të gjithë i mbledhim forcat bashkë rreth një kauze kaq të rëndësishme e humanitare, e këtë po e bëjmë në muajin e shenjtë të Ramazanit, që është muaj i mirësisë e solidaritetit ndërnjerëzor.

"Populli ynë, populli i Kosovës, e ka traditë që gjithnjë t'i qëndrojnë pranë njëri-tjetrit. Solidaritetin e kemi kultivuar në vazhdimësi ashtu siç i jemi gjetur pranë edhe shtetit turk në muajin shkurt pas tërmetit shkatërrues, e sërish jemi edhe sonte këtu për

ta demonstruar shpirtin human për qytetarët turq që kanë nevojë edhe më tej për ndihmën dhe përkrahjen tonë", ka thënë Osmani.

Ky aktivitet që mban emrin "Art dhe shpresë", sipas presidentes, është një përpjekje që sadopak t'u dalim ndihmë miqve tanë në Turqi dhe të gjithë atyre që pësuan nga tërmeti i shkurtit i këtij viti, i cili mori mijëra jetë dhe la shumë njerëz pa strehë. "Secili nga ne mund të bëjë diçka pak që për ta do të thotë shumë. Ata që më së shumti e treguan shpirtin solidar të Kosovës ishin ushtarët tanë të FSK-së dhe Shoqata e Kërkim-Shpëtimit. Ata shpëtuan jetë dhe u shndërruan në krenarinë e vendit tonë. Natyrisht që pasojat



e kësaj tragedie janë tepër të mëdha. Për fat të keq, jetët nuk kthehen më, por janë lidhjet

ndërmjet popujve, lidhjet e fuqishme që janë krijuar gjatë kësaj periudhe, që sadopak do

t'u ndihmojnë që ta zbutin këtë dhimbje", ka theksuar presidentja.

Kurti bëri homazh në Marec dhe Makoc: Angazhim për drejtësi për viktimat, ndëshkim për kriminelët



PRISHTINË, 19 PRILL - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka bërë homazhe në kompleksin e varrezave të dëshmorëve dhe martirëve në fshatin Marec të komunës së Prishtinës në shënimin e 24-vjetorit të rënies heroike të 27 dëshmorëve dhe vrasjes së 16 martirëve.

Kurti tha se bëhet fjalë për një betejë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e cila ua futi tmerrin forcave armike serbe, të cilat më pastaj në fshatin Makoc e shfrynë mllëfin e tyre nga humbja e kësaj betejë mbi civilët e pafajshëm e të pambrojtur.

Ai tha se si institucione të Republikës, si politikanë përfaqësues, si qytetarë të këtij vendi u jemi përjetë mirënjohës e falënderues, gjithashtu shprehim zotimin tonë edhe për kujtime e përkujtime institucionale,

gjithashtu edhe për angazhimin për drejtësi për viktimat e për ndëshkim për kriminelët.

Nga Mareci kryeministri bëri homazhe në Makoc, në masakrën më të madhe në komunën e Prishtinës, ku ndërmjet datave 19 dhe 23 prill u vranë gjithsej 115 civilë, fëmijë e pleq, që është një dëshmi e radhës së gjenocidit të Serbisë, që u mundua ta shfarosë popullin shqiptar nga trojet e veta stërgjyshore.

Bashkë me kryeministrin Kurti në homazhe ishin edhe ministri i Shëndetësisë, njëherësh kryetar i Qendrës së Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë, Arben Vitia, zëvendësministri i Mbrojtjes, Shemi Sylja, asamblistë të Lëvizjes Vetëvendosje në Kuvendin Komunal të Prishtinës dhe aktivistë të tjerë.

Kurti e Aliu vizituan Agjencinë Kadastrale të Kosovës

PRISHTINË, 19 PRILL - Kryeministri Albin Kurti së bashku me ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, kanë vizituar Agjencinë Kadastrale të Kosovës. Ata janë pritur nga

zëvendës drejtori i përgjithshëm i AKK-së, Avni Ahmeti, me bashkëpunëtorë, dhe janë njoftuar për projektet, punët, aktivitetet dhe planifikimet afatshkurta dhe afatgjata që ka ky institucion për vitet në vazhdim.

Pas prezantimit të punës nga udhëheqësit e AKK-së, Kurti në fjalën e tij premtoi mbështetje për këtë institucion për Ligjin për Kadastër, aktivitetet e projektit të Bankës Botërore dhe vitalizimin e Zyrave Kadastrale Komunale në tri komunat veriore.



ShBA-ja pret zbatimin e marrëveshjeve të mëparshme në mes të Kosovës dhe Serbisë

“ShBA-ja dhe BE-ja presin nga të dyja palët t'i përmbushin obligimet e tyre dhe t'i zbatojnë marrëveshjet e mëparshme nga dialogu, përfshirë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, siç kanë konfirmuar se do të bëjnë dy udhëheqësit në takimin e 18 marsit në Ohër”, thuhet në përgjigjen me shkrim të Departamentit amerikan të Shtetit

PRISHTINË, 19 PRILL - Shtetet e Bashkuara të Amerikës presin nga Kosova dhe nga Serbia që t'i zbatojnë të gjitha marrëveshjet e arritura gjatë negociatave të mëparshme, përfshirë formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, ka thënë Departamenti amerikan i Shtetit për “Zërin e Amerikës”.

Një muaj më parë në Maqedoninë e Veriut, përfaqësuesit e Kosovës dhe të Serbisë, arritën, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian dhe me mbështetjen e ShBA-së, një marrëveshje gojore për zbatimin e propozimit evropian për normalizimin e marrëdhënieve. “ShBA-ja dhe BE-ja presin nga të dyja palët t'i përmbushin obligimet e tyre dhe t'i zbatojnë marrëveshjet e mëparshme nga dialogu, përfshirë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, siç kanë konfirmuar se do të bëjnë dy udhëheqësit në takimin e 18 marsit në Ohër”, thuhet në përgjigjen me shkrim të DASH-it për “Zërin e Amerikës” ndaj pyetjes për zbatimin e asaj për të cilën palët janë marrë vesh në Ohër.

DASH-i ka theksuar se ShBA-ja mbetet e angazhuar në mënyrë aktive për mbështetjen e Kosovës dhe të Serbisë për zbatimin e marrëveshjeve. “Ne jemi të përqendruar mbi zbatimin e Marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve mes dy vendeve në mënyrë që t'u ndihmojmë atyre të

zhvillojnë marrëdhënie më paqësore dhe më të parashikueshme si fqinjë, gjë që do të mundësonte stabilitet, siguri dhe prosperitet më të madh në rajon”, thuhet në deklaratën e DASH-it.

Më 18 prill Bashkimi Evropian ka formuar një Komision të Përbashkët për mbikëqyrjen e zbatimit të marrëveshjes së arritur nga udhëheqësit e Kosovës dhe të Serbisë, në takimin e tyre në Ohër, më 18 mars. Siç është bërë me dije nga Brukseli, Komisioni do të kryesohet nga përfaqësuesi i posaçëm i BE-së për dialogun, Mirosllav Lajçak. Kosova do të përfaqësohet nga ambasadori i saj në Belgjikë, Agron Bajrami, ndërsa Serbia nga kryenegociatori i saj Petar Petkoviç. “Detyra e Komisionit të Përbashkët është që ta mbikëqyrë zbatimin e Marrëveshjes për rrugën drejt normalizimit të raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe aneksin e zbatimit të saj”, ka thënë zëdhënësi i BE-së, Peter Stano. Formimi i Komisionit të Përbashkët është paraparë në aneksin e zbatimit të Marrëveshjes për rrugën drejt normalizimit të raporteve. Udhëheqësit e Kosovës dhe Serbisë janë pajtuar për tekstin e kësaj marrëveshjeje në një takim të zhvilluar më 27 shkurt në Bruksel, ndërsa në bisedimet në Ohër ata janë marrë vesh për aneksin e zbatimit të kësaj marrëveshjeje. Megjithatë, ata nuk kanë nënshkruar asgjë.



Petkoviç: Në raundin e ri të dialogut flasim për Asociacionin

Drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petkoviç, ka thënë të mërkurën se raundi i ardhshëm i dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, i cili është paraparë të mbahet më 2 maj në Bruksel, do t'i dedikohet Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë. Ai ka thënë do të ndërmerren “hapat më konkretë” përkitazi me formimin e Asociacionit, jo siç dëshiron kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, “por siç është rënë dakord përmes katër marrëveshjeve nga vitet 2013 dhe 2015”.

Petkoviç ka thënë për Radiotelevizionin e Serbisë se pika e parë është prezantimi i projektstatutit të Asociacionit nga Ekipi Menaxhues, pasuar nga një

diskutim për propozimin, i cili duhet t'i përfshijë të gjitha pikat e parimeve të përgjithshme nga viti 2015. “Ne do të ngulmojmë për këtë, kjo është në frymën e marrëveshjes dhe për të jemi marrë vesh në Ohër. Sigurisht ne duhet të ngulmojmë për këtë, se pa Asociacionin është thjesht e pamundur të flitet për diçka tjetër”, ka theksuar Petkoviç.

Petkoviç ka thënë për RTS-në se Kosova ka refuzuar ta formojë Asociacionin që fiks 10 vjet prej nënshkrimit të Marrëveshjes së Brukselit dhe ka pohuar se komuniteti ndërkombëtar bart përgjegjësi të veçantë për këtë. “Kur e shikoni çdo gjë që ka ndodhur në 10 vjetet e fundit, do të shihni se komuniteti ndërkombëtar - Bashkimi

Evropian dhe ata që e kanë mbështetur procesin e dialogut - bartin një përgjegjësi të veçantë, sepse ata ishin të obliguar t'i bënin trysni Prishtinës për formimin e Asociacionit”, ka deklaruar Petkoviç. Sipas tij, Asociacioni përbën “themelin e procesit të dialogut” dhe se Serbia ka hyrë në këtë proces për t'i siguruar të drejtat kolektive dhe individuale për popullin serb përmes atij Asociacioni siç parashihet në Marrëveshjen e Brukselit dhe marrëveshje të tjera.

Ai ka theksuar se Asociacioni është kusht kyç i Beogradit për vazhdimin e procesit të normalizimit të marrëdhënieve me Kosovën dhe se, sipas Marrëveshjes së Ohrit, formimi i tij është obligimi i parë për Kosovën.

Mbrojtja nis intervistimin e dëshmitarit të dytë në rastin Taçi dhe të tjerët



HAGË, 19 PRILL - Në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë edhe të mërkurën ka vazhduar gjykimi ndaj ish-kryerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), ish-presidentit Hashim

Thaçi, ish-kryeparlamentarëve Kadri Veseli dhe Jakup Krasniqi, si dhe ish-deputetit Rexhep Selimi. Mbrojtja e ish-presidentit Taçi ka filluar intervistimin e dëshmitarit të dytë të prokurorisë

në seancë private. Dëshmitari i dytë i Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS) po paraqitet për të tretën ditë me radhë para trupit gjykues, pasi dëshmia e tij filloi të hënën dhe

vazhdoi edhe të martën. Gjatë ditës së martë dëshmia është dëgjuar tërësisht e mbyllur për publikun, ndërsa të hënën një pjesë e intervistimit është bërë në seancë publike.

Para trupit gjykues në Hagë ai është paraqitur si anëtar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe ka folur për aktivitetin e këtij subjekti në Malishevë nga viti 1990.

Dëshmitari i mbrojtur ka thënë se ishte kyçur në UÇK dhe se në të njëjtën kohë kishte ushtruar edhe aktivitetin e tij në LDK. Ai ka pretenduar se shtabi i UÇK-së në Malishevë bënte presion që LDK-ja ta pushonte aktivitetin e saj në atë pjesë. Më tutje dëshmitari ka deklaruar se një pjesë e madhe e UÇK-së i njihte institucionet e atëhershme të Kosovës në krye me Ibrahim Rugovën e LDK-së. Pas më shumë se dy vjet në paraburgim, gjykimi ndaj ish-kryerëve të UÇK-së ka filluar më 3 prill me deklaratat hyrëse të palëve.

Thaçi, Veseli, Krasniqi dhe Selimi janë deklaruar të pafajshëm për të gjitha pikat e aktakuzës.

Çmimet e biletave në transportin ndërrurban mund të rriten për 25 për qind

PRISHTINË, 19 PRILL - Këshilli Drejtues i Shoqatës së Transportit rrugor ka kërkuar që çmimet e biletave për transportin ndërrurban të ngriten për 25 për qind. Këtë kërkesë e bëri Naser Januzi nga kompania "Barileva" në mbledhjen e Këshillit Drejtues. Ai tha se janë rritur shpenzimet, duke përmendur edhe çmimet e larta të pjesëve

të autobusëve. "Unë kisha propozuar që nga sot të kemi 25 për qind rritje të çmimeve. Janë rritur çmimet e pjesëve të autobusëve e ne nuk i kemi rritur", tha Januzi.

Kadri Rrahmani nga kompania "Cali" nga Gjakova ka thënë se sulmi ndaj tyre se nuk po i zbrasin çmimet e biletave pas rënies së çmimit të derivateve të naftës nuk

është në rregull. Sipas tij, ata kanë edhe shpenzime të tjera. Shkelzen Nikçi, nënkryetar i Unionit të Shoqatave të Transportit, ka thënë se Shoqata e Naftëtarëve është fajtorja kryesore për rritjen e çmimeve. Ai ka theksuar se kjo shoqatë mund të flasë vetëm për anëtarët e vet e jo për shpenzimet që kanë transportuesit.



Delegacioni i lartë i BQK-së përfundon pjesëmarrjen në takimet pranverore të FMN-së dhe BB-së

PRISHTINË, 19 PRILL - Delegacioni i lartë i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, i kryesuar nga ushtruesi i detyrës i guvernatorit, Bashkim Nurboja dhe Nora Latifi-Jashari, u.d. zëvendësguvernatore për Operacione Bankare, kanë përfunduar pjesëmarrjen në takimet pranverore të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore që u mbajtën në Uashington.

Gjatë kësaj vizite zyrtare delegacioni i BQK-së, përveç pjesëmarrjes në tryeza të parapara sipas agjendës së vizitës, ka zhvilluar shumë takime me zyrtarë të lartë të Fondit Monetar Ndërkombëtar, të Bankës Botërore, si dhe me homologë të bankave qendrore të vendeve të ndryshme.

Delegacioni është takuar me drejtorin për Evropë të Fondit Monetar Ndërkombëtar, Alfred

Kammer.

Në këtë takim është diskutuar për bashkëpunimin e deritashëm në mes të BQK-së dhe FMN-së si dhe projektet që janë në zhvillim e sipër.

Guvernatori i BQK-së, Bashkim Nurboja, ka falënderuar FMN-në për mbështetjen e vazhdueshme dhe ndër vite që i ka dhënë Kosovës dhe BQK-së për avancimin e saj në të gjitha fushat që i mbulon.

Gjatë pjesëmarrjes në takimet pranverore të FMN-së dhe të BB-së, delegacioni i lartë i BQK-së ka marrë pjesë në grupin e punës për marrëveshjen e re të konstituencës. Sipas agjendës së pjesëmarrjes në kuadër të takimeve pranverore, delegacioni i BQK-së ka takuar edhe zëvendësdrejtorin menaxhues të FMN-së, Bo Li.

Në kuadër të këtyre takimeve është diskutuar për zbatimin e



rekomandimeve nga raportet e mëparshme të asistencave teknike si dhe shprehjet e interesit për përkrahje në të ardhmen.

Takimet vjetore të organizuara nga Fondi Monetar

Ndërkombëtar dhe Banka Botërore mbledhin bankierë qendrorë, ministra të financave dhe të zhvillimit ekonomik, parlamentarë, drejtues të sektorit privat, përfaqësues nga organizata të shoqërisë civile

dhe akademike për të diskutuar çështje me rëndësi globale, përfshirë perspektivën ekonomike botërore, zhdukjen e varfërisë, zhvillimin ekonomik dhe efektivitetin e ndihmës.

Gërxhaliu: Kontributi dhe potenciali i diasporës është shumë më i madh sesa që pranohet në Kosovë



